

**KËSHILLI I BASHKISË  
KORÇË**

---

**VENDIM**

Nr 9      Datë 11.2, 2009

**PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE DHE  
ADMINISTRIMIN E TYRE NË QYTETIN E KORÇËS SI DHE  
PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET  
ADMINISTRATIVE**

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme pasi morri në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave, bazuar në Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" neni 35 dhe në Ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" Ligjin nr 9920 datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr 24 datë 02.09.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

**VENDOSI :**

Të miratojë nivelet e mëposhtme të taksave dhe tarifave vendore si më poshtë vijon :

**A.TAKSAT VENDORE**

**Llojet, baza tatimore, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, koha e kryerjes së tyre dhe agjenti tatimor.**

**1. TAKSA VENDORE MBI BIZNESIN E VOGËL.**

Taksa vendore mbi biznesin e vogël llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit, qoftë ky subjekt fizik apo juridik, vendas apo i huaj, që realizon një të ardhur bruto vjetore (qarkullim) më të vogël apo të barabartë me 8.000.000 lekë.

Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 Prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 Korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 Tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 Janar e vitit të ardhshëm fiskal.

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës vendore mbi biznesin e vogël është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë.**

Kategoritë e bazës dhe nivelet e taksës vendore mbi biznesin e vogël paraqiten si më poshtë vijojnë:

Nr	Xhiro/aktivitet	Deri në 2000	NË MIJË LEKË					
			2000 - 3000	3000 - 4000	4000 - 5000	5000 - 6000	6000 - 7000	7000 - 8000
a)	<b>Shitje me pakicë :</b> Çdo njësi tregëtimi bulmet, mish. peshk. Çdo njësi tregëtimi fruta – perime. ushqimore. Çdo njësi tregëtimi artikuj industriale (veshje, parfumeri, argjendari, etj) Bar – Bufe, restorant, pub, diskoteka. kafe – internet, fast – food, loja fati, etj të ngjashme me to.	25	48	63	78	93	108	123
b)	<b>Shitje me shumicë :</b> Magazina dyqane etj të cilat realizojnë shitje me shumicë të artikujve që tregëtojnë.	25	48	63	78	93	108	123
c)	<b>Prodhim :</b> Përpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie, letre, kartoni, etj të ngjashme me to. Prodhim tulla, tjegulla, blloqe betoni. furra gëlqereje etj të ngjashme me to. Prodhime me karakter ushqimor si : prodhime buke, ëmbëlsirash, mishi. peshku, bulmeti, pijesh. etj të ngjashme me to. Prodhim konfeksionesh etj të ngjashme me to. Prodhim përpunim produktesh farmaceutike etj të ngjashme me to.	23	45	60	75	90	105	120
d)	<b>Shërbime :</b> Riparimi i artikujve elektro shtepiake. radio televizorë, frigoriferë, lavatriçe, magnetofonë, pajisje fonie etj të ngjashme me to. Shërbime fotokopimi, sallon bukurie, autoservise, kurse për makina (autoshkolla) për traktorë, për kompjuter e për parukeri. agjensi doganore. agjensi këmbimi valutor. agjensi turizmi. motele, pikat e shërbimit të makinave (autoservis). parkim i makinave, lavanteritë, pastrimi kimik, shërbime të rojeve civile, sallat e lojrave të ndryshme (gjimnastikë, aerobi, cirqe, kënde lojrash për fëmijë, pingpong etj) etj shërbime të ngjashme me shërbimet e lartpërmendura.	20	43	58	73	88	103	118
e)	<b>Profesione të lira :</b> Avokat, noter, mjek, mjek laborant, stomatolog, farmacist, ekonomist kontabël të miratuar, ekspert kontabël të autorizuar, mësues, veteriner, agronom, botues, inxhinier, arkitekt, projektues. etj profesione të lira të cilat ushtrohen në njësi fikse apo ambiente të ndryshme. Galeritë e artit të piktoreve, skulptorëve dhe artistëve të tjerë që prodhojnë dhe tregëtojnë objekte artistike.	30	53	68	83	98	113	128

	Institucionet jopublike të edukimit (shkollat, kopshtet apo çerdhet), shërbimet në klinika të specialiteteve të ndryshme mjekësore, shërbimet në laboratorët e diagnostifikimit etj në rastet kur nuk e kalojnë kufirin e kalimit në T.V.SH.							
f)	<b>Ambulant:</b> Subjekte që nuk kanë vendndodhje fikse si shitësit e akulloreve, pijeve freskuese, gazetave, revistave, bananeve, zburimeve artistike, veshmbathjeve, ilustraxhinje etj të kësaj natyre Tregëtia ambulante në tregje publike të miratuar nga njësia e qeverisjes vendore dhe tregjet private.	5						
g)	<b>Transport</b>							
1)	<b>Transport pasagjerësh</b>							
	Automjet deri 5 vende	17,5	-	-	-	-	-	-
	Automjet 6-9 vende	35	-	-	-	-	-	-
	Automjet 10-25 vende	40	-	-	-	-	-	-
	Automjet 26-42 vende	45	-	-	-	-	-	-
	Automjet mbi 42 vende	48	-	-	-	-	-	-
2)	<b>Transport Mallrush</b>		-	-	-	-	-	-
	Automjet deri 2 tonë	28	-	-	-	-	-	-
	Automjet 2-5 tonë	40	-	-	-	-	-	-
	Automjet 5-10 tonë	48	-	-	-	-	-	-
	Automjet 10-16 tonë	50	-	-	-	-	-	-
	Automjet mbi 16 tonë	75	-	-	-	-	-	-
3)	<b>Transport Ujor</b>							
	Transport detar brenda vendit	55	-	-	-	-	-	-
	Transport në liqene brenda vendit	48	-	-	-	-	-	-
	Varka për shëtitje	15	-	-	-	-	-	-

- Për individët **studentë** të cilët janë diplomuar në vitet 2007, 2008 dhe gjatë vitit 2009, që do të hapin një aktivitet biznesi i vogël në territorin e Bashkisë Korçë, gjatë periudhës **01.01.2009 – 31.12.2009**, për periudhën e vitit 2009 gjatë së cilës do të ushtrojnë aktivitet, do të paguajnë **30%** më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.
- Për individët që do të hapin aktivitet me objekt **turizmin si Bed & Breakfast, Agjensi Turistike, autobus turistik – city tour, restorante të mirëfillta si dhe agjensi organizimi eventesh të ndryshme festive**, gjatë periudhës **01.01.2009 – 31.12.2009**, për periudhën e vitit 2009 gjatë së cilës do të ushtrojnë aktivitet, do të paguajnë **30%** më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.
- 10 (dhjetë) bizneset që do të hapen në kuadrin e **projektit Inkurajimi i sipërmarrësve të rinj** (Young Entrepreneur Project), gjatë periudhës **01.01.2009 – 31.12.2009**, për periudhën e vitit 2009 gjatë së cilës do të ushtrojnë aktivitet, do të paguajnë **30%** më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.
- 10 (dhjetë) bizneset që do të hapen në kuadrin e **projektit të UNICEF – it** (personat që janë në skemën e ndihmës ekonomike dhe do të hapin një aktivitet privat) gjatë periudhës **01.01.2009 – 31.12.2009**, për periudhën e vitit 2009 gjatë së cilës do të ushtrojnë aktivitet, do të paguajnë **30%** më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.
- Subjektet e biznesit të vogël si bare, restorante, internet kafe, butik dhe laborator fotografik, që bëhen pjesë e projektit **PRO STUDENT**, për vitin ushtrimor 2009 do të paguajnë **20%** më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.

- Subjektet e biznesit të vogël që do të paguajnë të plotë vlerën e detyrimit për taksën vendore për vitin në vazhdim brenda datës **31 Mars** do të paguajnë **5%** më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.

## 2. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME.

Në këtë zë përfshihen **Taksa mbi ndërtesën** dhe **Taksa mbi tokën bujqësore**.

### 2.a Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor.

Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e së drejtës së pronësisë.

Baza e kësaj takse është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi e taksapaguesit përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë këtë pronësi. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi ndërtesën janë si vijon :

Kategoritë minimale të ndërtesave	Lekë/m <sup>2</sup> në vit
<b>I . Ndërtesa banimi</b>	8.4
<b>II. Ndërtesa për ushtrim aktiviteti me qëllim përfitimi</b>	150
- për tregëti dhe shërbime - ndërtesa prodhimi - ndërtesa për shërbime shëndetësore, artizanale, social kulturore, arsimore shkencore - ndërtesa për shërbime tregëtare, administrative, etj - të tjera (të gjitha ndërtesat që nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme)	
<b>Të tjera :</b> - Ndërtesat në pronësi ose në përdorim të organizatave jofitimprurëse, fondacioneve. - Objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit, si dhe sipërfaqe objektesh të pashfrytëzuara ku nuk zhvillohet aktivitet.	30

Për ato kategori ndërtesash banimi të cilat janë të regjistruara si seli të subjekteve tregëtare, Taksa e Pasurisë përllogaritet dhe paguhet si Kategoria II “Ndërtesa për ushtrim aktiviteti me qëllim përfitimi”, për atë pjesë të sipërfaqes së ndërtesës në të cilën ushtrohet veprimtaria tregëtare, duke u përjashtuar nga Kategoria I “Ndërtesa Banimi”.

### 2.b Taksa mbi tokën bujqësore.

Taksa mbi tokën bujqësore është detyrim vjetor. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës në hektarë, në pronësi të taksa pagesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon :

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës bujqësore	Vlera e taksës në lekë/hektar/vit
I	4200
II	3500
III	2800
IV	2300
V	1900
VI	1600
VII-X	1400

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën dhe taksën mbi tokën bujqësore është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë. Për sa i përket kategorisë “çdo familje” për vitin 2009 detyrimi vjetor fiks deri në nivelin 1.000 (njëmijë) lek do të shpërndahet për periudhën gusht 2009 – nëntor 2009 të vitit 2009 dhe do të paguhet së bashku me faturën mujore të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, pranë sporteleve të Ujësjellës Kanalizime Korçë.

### 3. TAKSA E FJETJES NE HOTEL.

Niveli i taksës është 5% e çmimit të fjetjes për person ose për dhomë, për një natë. Me “hotel” kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë.

### 4. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA.

Baza e taksës është vlera në lek e investimit të ri që kërkohet të kryhet. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënie e lejes së ndërtimit.

Niveli i taksës sipas zonave është :

#### ZONA “A” ME RRJET INXHINIERIK MË TË KONSOLIDUAR

- Për banesat kolektive dhe objektet që nuk përfshihen në kategoritë e tjera, niveli i kësaj takse është 3%.
- Për objektet administrative & shërbimi, niveli i kësaj takse është 2%.
- Për objektet për qëllime publike si kopshte, çerdhe, shkolla, spitale qofshin këto publike apo private, niveli i kësaj takse është 1%.
- Për ndërtimet në infrastrukturë si rrugë, ujësjellës, kanalizime, ndriçim publik, telefon (të gjitha këto publike), niveli i kësaj takse është 1%.
- Për banesat individuale, niveli i kësaj takse është 1%.

#### ZONA “B” ME RRJET INXHINIERIK MË PAK TË KONSOLIDUAR

- Për banesat kolektive dhe objektet që nuk përfshihen në kategoritë e tjera, niveli i kësaj takse është 2%.
- Për objektet administrative & shërbimi, niveli i kësaj takse është 1,5%.
- Për objektet për qëllime publike si kopshte, çerdhe, shkolla, spitale qofshin këto publike apo private, niveli i kësaj takse është 1%.
- Për ndërtimet në infrastrukturë si rrugë, ujësjellës, kanalizime, ndriçim publik, telefon (të gjitha këto publike), niveli i kësaj takse është 1%.
- Për banesat individuale, niveli i kësaj takse është 1%.

#### ZONA “C” ME RRJET INXHINIERIK TË PA KONSOLIDUAR

- Për banesat kolektive dhe objektet që nuk përfshihen në kategoritë e tjera, niveli i kësaj takse është 1,5%.
- Për objektet administrative & shërbimi, niveli i kësaj takse është 1%.
- Për objektet për qëllime publike si kopshte, çerdhe, shkolla, spitale qofshin këto publike apo private, niveli i kësaj takse është 1%.
- Për ndërtimet në infrastrukturë si rrugë, ujësjellës, kanalizime, ndriçim publik, telefon (të gjitha këto publike), niveli i kësaj takse është 1%.
- Për banesat individuale, niveli i kësaj takse është 1%.
- Për çdo lloj ndërtese, që do të plotësojë kërkesat e programit të Bashkisë Korçë për rritjen e efijencës së energjisë (termoizolim), niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë do të jetë 1% për të tre zonat e lart përmendura.

Këto përqindje do të llogariten në bazë të vlerës së investimit që do të kryhet sipas koston mesatare të ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave për vitin përkatës.

### 4/1 TAKSA NGA NDËRTIMET E REJA PËR STUDIME PROJEKTIVE.

Niveli i taksës është 1% të vlerës së investimit që do të kryhet sipas kostos mesatare të ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave për vitin përkatës, fond ky i cili depozitohet për llogari të financimit të studimeve urbanistike në pushtetin vendor.

**Struktura e ngarkuar për përlogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, taksës nga ndërtimet e reja për studime projektive dhe vjeljen e tyre, është Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit Urban pranë Bashkisë Korçë.**

#### **5. TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME**

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Bazuar në Ligjin nr 9716 datë 16.04.2007 "Për disa ndryshime në Ligjin nr 8438 date 28.12.1998 Për Tatimin mbi të Ardhurat", kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, tokë e ndërtesa, **tatohet me 10 për qind të fitimeve kapitale të realizuara.** Kjo nuk zbatohet në rastet e shkëmbimit të së drejtës së pronësisë mbi tokën me të drejtën e pronësisë mbi ndërtesën e ndërtuar mbi tokë. Tatimi paguhet nga individë që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të pasurive të mësipërme, në përputhje me aktet ligjore. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme janë të detyruara që, brenda 10 (dhjetë) ditëve, të transferojnë për llogari të njësisë vendore (Bashkisë Korçë) taksën e paguar.

**Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila në rolin e agjentit të taksës përfiton 3% të shumës së arkëtuar dhe diferenca derdhet për llogari të buxhetit të njësisë vendore (Bashkisë Korçë) brenda 10 (dhjetë) ditëve.**

#### **6. TAKSA E REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË MJETEVE.**

Baza e taksës është lloji i mjetit të transportit rrugor. Niveli i taksës shprehet në një kuotë të caktuar sipas llojit të mjetit. Kategoritë dhe nivelet sipas mjeteve përcaktohen në lidhjen përkatëse të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006.

**Agjenti tatimor për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor përfiton 5% të shumës së arkëtuar dhe Drejtoria e Qarkullimit Rrugor 1% të shumës së arkëtuar.**

#### **7. TAKSA PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE.**

Baza e taksës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në metër katror e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim mujor i taksa paguesit duke shumëzuar bazën e taksës (sipërfaqen) me nivelin tregues të saj. **Niveli i kësaj takse për Bashkinë Korçë është 90 Lekë / m<sup>2</sup> në muaj.**

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës për zënie të hapësirave publike është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë.**

#### **8. TAKSA E TABELËS.**

Kjo taksë aplikohet për të gjitha subjektet fizike, juridike, private e shtetërore, vendas apo të huaj që kryejnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Bashkisë Korçë me përjashtim të tregëtareve ambulante të cilët janë të përjashtuar, për arsye se nuk kanë detyrim për ta vendosur atë. Baza dhe niveli i kësaj takse përcaktohet nga Këshilli i Bashkisë.

Niveli i kësaj takse për Bashkinë Korçë është si më poshtë vijon :

- Tabelë e shprehur në shqip 1.000 lekë
- Tabelë e shprehur në gjuhë të huaj 5.000 lekë

Kjo taksë aplikohet tek tabelat të cilat nuk e kalojnë përmasën 50 cm X 60cm. Detyrimi për taksën e tabelës është vjetor. Afati i pagesës është brenda datës 31 mars të vitit fiskal për subjektet e regjistruara dhe për subjektet e reja në momentin kur lind detyrimi. Theksojmë se kur detyrimi për taksën lind 6 mujorin e dytë të vitit fiskal pagesa do të jetë 50% e taksës.

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së tabelës është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë.**

## **9. DHËNIE AUTORIZIMI PËR PIKAT E TREGËTIMIT ME PAKICË TË KARBURANTEVE DHE NJËSITË E SHITJES SË LËNDËVE DJEGËSE DHE BOMBOLAVE TË GAZIT**

Bazuar në Ligjin Nr.8450, datë 24.2.1999 “PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGËTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE” të ndryshuar me Ligjin Nr .9218, datë 08.04.2004 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8450, DATË 24.2.1999 “PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGËTIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 129, datë 18.03.1999 “PËR PROÇEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE E TË AUTORIZIMEVE PËR TREGËTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT E TË NËNPRODUKTEVE TË TYRE” të ndryshuar me Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 170, datë 25.04.2002 & Nr. 563, datë 27.08.2004 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME PËR PROÇEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE E TË AUTORIZIMEVE PËR TREGËTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT E TË NËNPRODUKTEVE TË TYRE”, Bashkia Korçë jep autorizime për personat juridikë apo fizikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregëtimin e karburanteve për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse) në territorin e Bashkisë Korçë. Autorizimet jepen nga Bashkia Korçë për një periudhë deri në 5 (pesë) vjet me të drejtë përsëritjeje dhe pagesa për dhënie autorizimi për dy kategoritë e mësipërme është si më poshtë vijon :

\* Pagesë për dhënie autorizimi për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës për automjete dhe vajra lubrifikante **100.000 lekë.**

\* Pagesë për dhënie autorizimi për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit të lëngshëm të naftës **50.000 lekë.**

**Struktura e ngarkuar për dhënie e këtij autorizimi është Qendra e Liçensimit pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit të Bashkisë Korçë.**

### **B. TARIFAT VENDORE**

I.	LLOJI I TARIFËS	VLERA
1.	<b>TARIFË REGJISTRIMI (PËR LEJE USHTRIMI VEPRIMTARIE EKONOMIKE)</b>	
	- Për persona juridikë, shtetërorë & privatë, vendas & të huaj, biznes i vogël apo i madh	20.000 lekë
	- Për persona fizikë vendas & të huaj biznes i madh	20.000 lekë
	- Për persona fizikë vendas & të huaj biznes i vogël	15.000 lekë
	- Për persona fizikë që bëjnë tregëti dhe kryejnë shërbime ambulante	2.500 lekë

2.	TARIFË PËR PASTRIM DHE HEQJE MBETURINASH	
	- çdo familje	1.100 lekë në vit
	- çdo njësi tregëtimi për bulmet, mish, peshk B.V	20.000 lekë në vit
	- çdo njësi tregëtimi vetëm për fruta – perime në tregun e shumicës dhe në qytet	20.000 lekë në vit
	- çdo njësi tregëtimi e përzjerë për fruta – perime & ushqimore B.V (minimarkete)	12.000 lekë në vit
	- çdo njësi kantine	20.000 lekë në vit
	- çdo njësi tregëtimi për artikuj industrialë B.V	10.000 lekë në vit
	- për restorante, bar – bufe, diskoteka, lojra fati, bilardo, etj B.V	20.000 lekë në vit
	- për hotele, motele, komplekse turistike B.V	30.000 lekë në vit
	- për konvikte, pensione, shtëpi pushimi, spitale, martenitete	
	• shtetërore	30 lekë vit / dhomë
	• private	750 lekë vit / dhomë
	- për mjedise administrative (zyra, salla mbledhjesh)	
	• shtetërore	100 lekë vit / dhomë
	• private	750 lekë vit / dhomë
	- për institucione social – kulturore, sportive, ekspozita & panairë	10.000 lekë vit / njësi
	- për çdo njësi shërbimi dhe artizanati B.V (riparimi i artikujve elektro shtëpiake, fotokopje, sallon bukurie, autoservise, autoshkolla, kurse për kompjutera e parukeri, agjensi doganore, agjensi këmbimi valutor, agjensi turizmi, parkinge, pastrim kimik, shërbim roje civile, salla gjimnastike & aerobie, cirqe, kënde lojnash për fëmijë, ping pong etj).	5.000 lekë vit / njësi
	- profesione të lira B.V :	
	(mjek, mjek laborant, stomatolog, farmacist, klinika e shërbime të tjera mjekësore)	20.000 lekë vit / njësi
	- profesione të lira B.V :	
	(avokat, noter, ekonomist kontabël të miratuar, ekspert kontabël të autorizuar, botues, inxhinier, arkitekt, projektues, mësues, veteriner, agronom, murator, karpentier, elektrikist etj, profesione të lira të cilat ushtrohen në njësi fikse apo ambiente të ndryshme si dhe galeritë e artit të piktorëve, skulptorëve dhe artistëve të tjerë që prodhojnë dhe tregëtojnë objekte artistike)	7.000 lekë në vit
	- për çdo njësi prodhimi B.V	20.000 lekë në vit
	- subjekte biznes i vogël që tregëtojnë në tregun e lirë të qytetit	2.000 lekë në vit
	- të gjithë personat që klasifikohen si ambulantë	1.500 lekë në vit
	- për çdo njësi supermarketi (B.V & B.M)	50.000 lekë në vit
	- <b>Për subjektet e ndërtimit seli administrative :</b>	
	• Biznes i vogël	20.000 lekë në vit
	• Biznes i madh	40.000 lekë në vit
	- <b>Për subjektet e ndërtimit B.V &amp; B.M :</b>	
	• Njësi ndërtimi (për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla, kopshte, objekte banimi kolektive e tregëtare, zyra dhe të tjera të ngjashme me to)	70.000 lekë / kantier
	• Njësi ndërtimi banesa individuale	10.000 lekë / kantier
	• rikonstruksion i pjesëshëm	35.000 lekë / kantier



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• rikonstruksione të pjeshme banesa individuale</li> </ul> <p><b>KUR VEPRIMTARIA KLASIFIKOHET ME T.V.SH</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- për njësi tregëtimi, shërbimi e artizanati</li> <li>- për çdo njësi prodhimi</li> <li>- për çdo njësi hoteli, moteli, pikë turistike</li> </ul>	<p>5.000 lekë / kantier</p> <p>30.000 lekë në vit</p> <p>60.000 lekë në vit</p> <p>60.000 lekë në vit</p>
3.	<p><b>TARIFË REKLAME</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- e thjeshtë</li> <li>- elektronike</li> <li>- lojra fati dhe kazino</li> <li>- Veshjet me letër reklamuese të vetratave (xhamave) të ambjenteve ku zhvillohet aktiviteti privat (përveç lojrave të fatit) për të cilat paraprakisht është marrë leje pranë Bashkisë Korçë deri në 5 m<sup>2</sup></li> <li>- Çdo sipërfaqe reklamuese shtesë mbi 5 m<sup>2</sup> me letër reklamuese të vetratave (xhamave) të ambjenteve ku zhvillohet aktiviteti privat (përveç lojrave të fatit) për të cilat paraprakisht është marrë leje pranë Bashkisë Korçë</li> </ul>	<p>10.000 lekë / vit / m<sup>2</sup></p> <p>20.000 lekë / vit / m<sup>2</sup></p> <p>50.000 lekë / vit / m<sup>2</sup></p> <p>25.000 lekë / vit</p> <p>0 lekë / vit</p>
4.	<p><b>TARIFË PARKIMI</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- autovetura taksi 8 + 1</li> <li>- autovetura taksi 4 + 1</li> <li>- autobusë</li> <li>- autovetura</li> <li>- automjet transport malli deri 3,5 T (me ngarkesë)</li> <li>- automjet transport malli mbi 3,5 T (me ngarkesë)</li> <li>- motomjet transport malli (motokarro)</li> <li>- në vendparkime të rezervuara për autovetura dhe motokarro</li> <li>- në vendparkime të rezervuara për automjete transport malli</li> <li>- në vendparkime publike me pagesë</li> </ul>	<p>8.000 lekë / vit</p> <p>4.000 lekë / vit</p> <p>15.000 lekë / vit; 50 lek / orë</p> <p>1.500 lekë / vit</p> <p>2.000 lekë / vit</p> <p>1.500 lekë / vit</p> <p>1.500 lekë / vit</p> <p>10 lekë / orë</p> <p>20 lekë / orë</p> <p>50 lekë / orë</p>
5.	<p><b>TARIFË PËR THERJEN E BAGËTIVE</b></p> <p>a – Tarifë për therje në thertoren e Bashkisë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjedhë</li> <li>- Të imta</li> <li>- Derra</li> </ul> <p>b – Tarifë për çertifikimin në thertoren private</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjedhë</li> <li>- Të imta</li> <li>- Derra</li> </ul> <p>c – Tarifë për çertifikimin e mallrave për import – export</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- çertifikatë vërtetim për export</li> <li>- çertifikatë vërtetim për import</li> <li>- çertifikatë vërtetim për kafshë luksi</li> <li>- kafshë dhe shpendë gjahu</li> </ul> <p>d - Tarifë për çertifikatë për mallra që qarkullojnë brenda vendit (Produkte ushqimore me origjinë shtazore)</p>	<p>500 lekë</p> <p>200 lekë</p> <p>300 lekë</p> <p>200 lekë</p> <p>100 lekë</p> <p>150 lekë</p> <p>3.000 lekë</p> <p>5.000 lekë</p> <p>1.000 lekë</p> <p>1.000 lekë</p> <p>1.000 lekë</p>

6.	<b>TARIFË PËR TAVOLINA JASHTË LOKALEVE</b>	50 lekë/ditë/tavolinë
7.	<b>TARIFË PËR M<sup>2</sup> MUR TË JASHTËM PËR ÇDO NDËRTESE TË RE</b>	20 lekë
8.	<b>TARIFË PËR SERVITUTIN E KALIMIT NË PRONAT PUBLIKE</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për zonën qendër qyteti dhe bulevardet kryesore <ul style="list-style-type: none"> <li>• rrugë kalimi</li> <li>• hapësirat e tjera</li> </ul> </li> <li>- Për zonat e tjera të qytetit <ul style="list-style-type: none"> <li>• rrugë kalimi</li> <li>• hapësirat e tjera</li> </ul> </li> </ul>	180 lek/m <sup>2</sup> në muaj 250 lek/m <sup>2</sup> në muaj  150 lek/m <sup>2</sup> në muaj 200 lek/m <sup>2</sup> në muaj
9.	<b>TARIFË GJELBËRIMI</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Çdo familje</i></li> <li>- <i>Çdo njësi prodhimi :</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Biznes i vogël</li> <li>• Biznes i madh</li> </ul> </li> <li>- <i>Për subjektet e ndërtimit seli administrative :</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Biznes i vogël</li> <li>• Biznes i madh</li> </ul> </li> <li>- <i>Për subjektet e ndërtimit B.V &amp; B.M :</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njësi ndërtimi (për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla, kopshte, objekte banimi kolektive e tregëtare, zyra dhe të tjera të ngjashme me to)</li> <li>• Njësi ndërtimi banesa individuale</li> <li>• rikonstruksion i pjesshëm</li> <li>• rikonstruksione të pjesshme banesa individuale</li> </ul> </li> <li>- <i>Çdo njësi shërbimi dhe artizanati :</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Biznes i vogël</li> <li>• Biznes i madh</li> </ul> </li> <li>- <i>Profesione të lira :</i> (mjek, mjek laborant, stomatolog, farmacist, klinika e shërbime të tjera mjekësore) <ul style="list-style-type: none"> <li>• Biznes i vogël</li> <li>• Biznes i madh</li> </ul> </li> <li>- <i>Profesione të lira :</i> (avokat, noter, ekonomist kontabël të miratuar, ekspert kontabël të autorizuar, botues, inxhinier, arkitekt, projektues, mësues, veteriner, agronom, murator, karpentier, elektrikist etj, profesione të lira të cilat ushtrohen në njësi fikse apo ambiente të ndryshme si dhe galeritë e artit të piktorëve, skulptorëve dhe artistëve të tjerë që prodhojnë dhe tregëtojnë objekte artistike) <ul style="list-style-type: none"> <li>• Biznes i vogël</li> <li>• Biznes i madh</li> </ul> </li> <li>- <i>Çdo njësi tregëtimi me shumicë e pakicë, restorante, bar – bufe, pub, diskoteka, loja fati etj :</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Biznes i vogël</li> <li>• Biznes i madh</li> </ul> </li> <li>- <i>Çdo njësi hoteli, moteli, komplekse turistike :</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Biznes i vogël</li> <li>• Biznes i madh</li> </ul> </li> </ul>	300 lekë në vit  1.500 lekë në vit 3.000 lekë në vit  1.000 lekë në vit 2.000 lekë në vit  5.000 lekë / kantier  1.000 lekë / kantier 2.500 lekë / kantier 500 lekë / kantier  1.500 lekë në vit 3.000 lekë në vit  1.500 lekë në vit 3.000 lekë në vit  1.500 lekë në vit 3.000 lekë në vit  1.500 lekë në vit 3.000 lekë në vit  1.500 lekë në vit 3.000 lekë në vit

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Për institucione social – kulturore, sportive, ekspozita, panairë etj :</i></li> <li>• Biznes i vogël</li> <li>• Biznes i madh</li> <li>- <i>Subjekte biznes i vogël që tregëtojnë në tregun e lirë të qytetit :</i></li> <li>- <i>Të gjithë personat që klasifikohen si ambulante</i></li> <li>- <i>Për çdo njësi supermarketi :</i></li> <li>• Biznes i vogël</li> <li>• Biznes i madh</li> <li>- <i>Për institucionet &amp; mjediset administrative shtetërore :</i></li> <li>- <i>Për Partitë politike &amp; shoqatat</i></li> </ul>	<p>2.000 lekë në vit 4.000 lekë në vit</p> <p>1.000 lekë në vit 1.000 lekë në vit</p> <p>2.500 lekë në vit 5.000 lekë në vit</p> <p>5.000 lekë në vit 2.500 lekë në vit</p>
10.	<p><b>TARIFË PËR PËRDORIM TË TREGUT TË LIRË TË QYTETIT</b></p> <p>a) Për tregëtim mallra industriale</p> <p>b) Për tregëtim mallra ushqimore, fruta – perime, vezë</p> <p>c) Për tregëtim mish, peshk, bulmet</p>	<p>30 lek/m2/ditë 40 lek/m2/ditë</p> <p>50 lek/m2/ditë</p>
11.	<b>TARIFË PËR EKSPOZIM MALLI JASHTË DYQANIT</b>	30 lek/m2/ ditë
12.	<p><b>TARIFË DHËNIE LEJE</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kantina <ul style="list-style-type: none"> <li>- zona A</li> <li>- zona B</li> </ul> </li> <li>• Kënde lojnash</li> </ul>	<p>60 lek/m2/ditë 40 lek/m2/ ditë</p> <p>40 lek/m2/ditë</p>
13.	<p><b>TARIFË NDRIÇIMI</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Çdo familje</i></li> <li>- <i>Çdo njësi prodhimi :</i></li> <li>• Biznes i vogël</li> <li>• Biznes i madh</li> <li>- <i>Për subjektet e ndërtimit seli administrative :</i></li> <li>• Biznes i vogël</li> <li>• Biznes i madh</li> <li>- <i>Për subjektet e ndërtimit B.V &amp; B.M :</i></li> <li>• Njësi ndërtimi (për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla, kopshte, objekte banimi kolektive e tregëtare, zyra dhe të tjera të ngjashme me to)</li> <li>• Njësi ndërtimi banesa individuale</li> <li>• rikonstrukcion i pjesshëm</li> <li>• rikonstrukcione të pjesshme banesa individuale</li> <li>- <i>Çdo njësi shërbimi dhe artizanati :</i></li> <li>• Biznes i vogël</li> <li>• Biznes i madh</li> <li>- <i>Profesione të lira :</i> (mjek, mjek laborant, stomatolog, farmacist, klinika e shërbime të tjera mjekësore)</li> <li>• Biznes i vogël</li> <li>• Biznes i madh</li> <li>- <i>Profesione të lira :</i> (avokat, noter, ekonomist kontabël të miratuar, ekspert kontabël të autorizuar, botues, inxhinier, arkitekt, projektues, mësues,</li> </ul>	<p>400 lekë në vit</p> <p>2.500 lekë në vit 6.500 lekë në vit</p> <p>2.000 lekë në vit 5.000 lekë në vit</p> <p>3.000 lekë / kantier</p> <p>1.000 lek / kantier 2.000 lek / kantier 500 lek / kantier</p> <p>2.500 lekë në vit 6.500 lekë në vit</p> <p>2.500 lekë në vit 6.500 lekë në vit</p>

